



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Numri i lëndës: 2022:061522

Datë: 23.01.2025

Numri i dokumentit: 06771449

KA.nr.1189/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Veda Petrol” SH.P.K, me seli në Podujevë, me përfaqësues te autorizuar avokate Donike Krasniqi, kundër të paditurës Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë- Inspektorati i Tregut, për shkak të anulimit të vendimit me nr.prot.113-19, jashtë seancës, me datë 23.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit “Veda Petrol” SH.P.K, me seli në Podujevë, kundër të paditurës Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë- Inspektorati i Tregut, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit me nr.prot.113-19.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Veda Petrol” SH.P.K, me seli në Podujevë, me datën 30.03.2022 ka parashtruar padi, kundër të paditurës Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë- Inspektorati i Tregut, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit nr.prot.113-19.

Gjykata me datë 01.11.2024 paditësit i ka dërguar vërejtjen për pagesë të taksës, më të cilën e ka ftuar paditësin “Veda Petrol” SH.P.K që brenda afatit prej 15 ditëve nga marrja e kësaj vërejtje, t’a paguaj taksën gjyqësore për padi, në shumën prej 50 euro, duke e paralajmëruar paditësin se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se padia është tërhequr konform nenin 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Paditësi vërejtjen e taksës gjyqësore e ka pranuar me datë 18.11.2024, ndërsa edhe pas kalimit afatit konstatohet se paditësi nuk ka vepruar sipas vërejtjes për taksë. Andaj, gjykata konsideron se paditësi është tërhequr nga padia, dhe ka vendosur si në pikën I të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

KA.nr.1189/22, me datë 23.01.2025

Gjyqtarja  
Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLA JURIDIKE :** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.